



Numri i lëndës: 2024:026055

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05454818

C.nr.545/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen kontestimore të paditëses M.F. nga V. rr."Flaka e Janarit", të cilën sipas autorizimit e përfaqëson X.H., avokat në V., kundër të paditurës Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i pagës bazë në bazë të licensimit-kualifikimit shkollor, vlera e kontestit 2,988.90 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 11.03.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Apropohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses Miranda Baftijari nga V., **detyrohet** e paditura Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, në emër të kompensimit të diferencës në pagë në bazë të licensimit, për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 22.11.2022, përkatësisht për 24 muaj, t'ia paguajë nga 55.35 €, në shumë të përgjithshme **1,328.40 €**, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë me datë 19.01.2024, deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. Refuzohet e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses e kërkuar në emër të kompensimit të diferencës në pagë në bazë të licensimit, për periudhën qershor 2018 deri në muajin dhjetor 2020, përkatësisht 30 muaj, në shumën 1,660.50 €.

III. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia jë shpenzimet e procedurës në shumën 145 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Arsyetim

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 08.02.2024, në këtë gjykatë kanë ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi në bazë të licensimit, vlera e kontestit 2.988.90 €.

Me padi ka theksuar se paditësja punon si mësimdhënëse në ShFMU "Dëshmorët e 5 Prillit" në fshatin Smirë, Komuna V., SH.F.M.U. "Ndre Mjeda" në Kabash dhe SH.F.M.U. "28 Nëntori" në fshatin Vërban dhe nga gjykata ka kërkuar që në emër të kompensimit të diferencës në pagë në bazë të licensimit, për periudhën nga data 01.06.2018 deri me 31.12.2023, përkatësisht për 44 muaj, t'ia paguajë 27 % të pagës bazë apo nga 55.35 € në muaj, në shumë të përgjithshme 2,988.90 €. Bazën ligjore të kërkesëpadisë e ka mbështetur në Ligjin e Punës, Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) si dhe në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të

datës 29.08.2008. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë shumën 104 € për përpilimin e padisë dhe 41 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi obligimet e parapara nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministritë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Tutje ka theksuar se paditëses kanë nënshkruar kontratën e punës sipas kualifikimit mësimdhënës, kriter ky për themelimin e marrëdhënies së punës në bazë të së cilës edhe realizojnë të ardhura sipas kësaj pozite. E paditura gjithashtu është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës së paditëses, duke theksuar se ka kaluar afati i paraparë prej tri vitesh për të realizuar këtë të drejtë andaj, gjykatës i ka propozuar që të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 dhe 399.1 të LPK-së për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, pasi për vendosjen si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka gjetur se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike dhe as nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor meqë kërkesa e paditëses është qartazi e themeltë ndërsa, për vendosjen si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka gjetur se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë.

Gjykata ka gjetur se faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese, se paditësja është mësimdhënëse e kualifikuar me master, paga bazë e të cilës është 421 €, ndërsa nga e paditura është kompensuar vetëm pjesërisht edhe atë vetëm në shumën 58.32 € duke i mbetur borxh nga 55.35 € për muaj, fakte këto të mbështetura nga Licenca nr.1028490, Diploma nr. 1152, e datës 16.01.2018 dhe Lista e pagave EM00148715.

Gjykata i gjeti këto prova vendimtare për vendosje në këtë çështje kontestimore, pasi janë lëshuar nga organi kompetent, brenda kufijve të kompetencës e duke provuar kështu saktësinë e thënieve në këto dokumente, ashtu siç është paraparë në nenin 329.1 të LPK-së.

Duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare e as gjendjen faktike por vetëm bazën e kërkesëpadisë, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë së paditëses, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del e mbështetur në dispozitat e nenit 55. 1 të Ligjit të Punës që përcakton se: “I punësuari ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90. 5 i cili ka përcaktuar: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, lidhur me dispozitat e KKAK-së së datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, përkatësisht neni 3. 2 i cili ka përcaktuar se: “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratën Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”.

Numri i lëndës: 2024:026055
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05454818

Në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008, në fuqi deri me datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik nr. 08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësit, drejtorët, zëvendës drejtorët dhe bashkëpunorët profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike 19 %, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjeçar 27 % dhe me diplomë të 5 vjeçare, master dhe doktoraturë 35 % të pagës bazë.

Dispozitat e KKAK-së për V.n 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017-21.01.2021 dhe për V.n 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021-21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në këtë çështje kontestimore, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar në tërësi paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor apo 27 % të pagës bazë, ashtu siç është përcaktuar në Vendimin e Qeverisë dhe në nenin 7, pika 1.3 dhe 1.4 e KKAK-së dhe për këtë arsye, meqë ka qenë obligim i të paditurës të bëjë këtë kompensim dhe deri më tani nuk e ka përmbushur, gjykata e detyroi të paditurën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Paditësja, detyrimin për kompensim nga e paditura e ka kërkuar për periudhën nga data 01.06.2018 deri me 31.12.2022 mirëpo, pasi e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës së paditëses, gjykata vlerësoi afatshmërinë e kërkesës së saj dhe gjeti se padia është ushtruar me datë 14.01.2024, e bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke llogaritur 3 vite mbrapa nga data e ushtrimit të padisë, del se kërkesa e paditëses për kompensim nga data 01.06.2018 deri 31.12.2020, është e parashkruar.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës lidhur me faktin e zbatimit ose jo të kontratës kolektive, gjykata i gjeti të pa bazuara këto pretendime, pasi në rastin konkret baza juridike e kërkesës së paditëses buron nga Vendimi i Qeverisë. Edhe pretendimin se paditëses janë pranuar në punë sipas këtij kualifikimi dhe në kontratën e tyre të punës përcaktohen përqindjet sipas kualifikimit, për gjykatën ishte fakt jo relevant për këtë çështje kontestuese pasi përqindjet sipas kriterëve të licencimit të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë dhe në kontratë të punës kanë dallim mes vete dhe mësimdhënësit nuk kompensohen sipas këtyre kriterëve.

Lidhur me kamatën gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 449 lidhur me nenin 452.1 dhe 463.1 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin dhe për këtë arsye u detyrua të paguajë shpenzimet e paditëses edhe atë, për taksën gjyqësore për padi shumë 41 € dhe për përpilimin e padisë shumë 104 €, gjithsej 145 euro.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.

C.nr.545/2024, datë 11.03.2024

Gj y q t a r i,
Raif Fazliu

Numri i lëndës: 2024:026055
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05454818

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.